



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:211054

Datë: 15.01.2020

Numri i dokumentit: 00771927

P.nr.1010/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarve XH.A, I.F, dhe F.A, që të tre nga Fshati ..., rruga ...Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale që e kanë kryer në bashkëkryerje asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga 321 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1377-13/2019 e dt.24.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.15.01.2020, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Avdullah Abedini dhe të akuzuarve, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **XH.A** nga Fshati ..., Komuna Ferizaj, i lindur me datën ... në të njëjtin vend, nga i ati F... dhe e ëma M..., e gjinisë A..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i njëmbëdhjetë / 11 / fëmijëve, i pa punë i varfër , mbrohet në liri me numër personal ...

2. I akuzuari **I.F**, nga Fshati ..., Komuna Ferizajt, i lindur me datën ..., nga i ati F... dhe e ëma M..., e gjinisë A..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i shtatë / 7 / fëmijëve, i pa punë i gjendjes së varfër ekonomike shfrytëzues i Asistencës Sociale, mbrohet në liri, me numër personale

3. I akuzuari **F.A** , nga Fshati ..., Komuna Ferizaj , i lindur me datën ... , nga i ati Xh... dhe e ëma H..., e gjinisë D..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i tetë /8/ fëmijëve i gjendjes së varfër ekonomike shfrytëzues i Asistencës Sociale, mbrohet në liri, me numër personale ...

JANË FAJTORË

Sepse me dt. 14.06.2019 rreth orës 10:00 në fshatin ..., komuna e Ferizaj, me dashje në bashkëkryerje kishin dëmtuar murin e rrethojës së dëmtuarit H.D, në atë mënyrë që kishin

ndërtuar garazhe (shupa) mbi murin rreth 2 m të lartë, me ç'rast muri ishte plasaritur, dhe sipas vlerësimit të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm në vlerë rreth 1500 Euro.

-me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga 321 par. 1 lidhur me nenin 31 të të KPRK-së. (Kodi nr.06/L-074).

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 31,38,46, 47,48, 49, dhe 69 të KPRK-së, (Kodi nr.06/L-074). dhe neneve 365 dhe 453 paragraf 4 të KPPK-së të akuzuarit i

G J Y K O N

- Të akuzuarit **XH.A**, i vërteton dënimi me burg prej tre / 3 / muajve, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- Të akuzuarit **I.F**, i vërteton dënimi me burg prej tre / 3 / muajve, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- Të akuzuarit **F.A**, i vërteton dënimi me burg prej tre / 3 / muajve, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- I dëmtuari **H.D**, nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civile.

- Gjykata mbështetur në nenin 453 par 4 të KPPK-së të akuzuarit XH.A, I.F dhe F.A, i ka liruar nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore- të paushallit gjyqësor si dhe taksën për komentimin e viktimave të krimit, me që po të obligonte që të paguajnë do të rëndonin gjendjen ekonomike të tyre pasi shfrytëzues të asistencës sociale bazuar në dëshmitë e ofruara në shqyrtimin fillestar.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1377-13/2019 e dt.24.09.2019, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarit XH.A, I.F, dhe F.A, që të tre nga Fshati ..., rruga ...Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale që e kanë kryer në bashkëkryerje asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga 321 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke proceduar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.15.01.2020 mbajti shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedin dhe të akuzuarit XH.A, I.F dhe F.A, kurëse i dëmtuari H.D, nga fshati ..., Komuna Ferizaj, është ftuar me ftesë të rregullt por nga fletë kthesa për dorëzim personal shpërndarësi i ftesave ka shkruar se marrësi gjendet jashtë vendit.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të akuzuarit në afatin ligjor së bashku me ftesë për shqyrtimin fillestar kanë pranuar edhe nga një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarve janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën me të cilën janë ngarkuar të akuzuarit dhe pasi gjyqtari është bindur se të akuzuarit kanë kuptuar në tërësi aktakuzën e lexuar, të njëjtëve secilit veç e veç i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tyre lidhur me veprën për të cilën janë akuzuar.

I akuzuari XH.A, në shqyrtimin fillestar deklaroi se e ndien veten fajtorë dhe e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se nuk ka pasur për qëllim që ti shkaktoj dëm të dëmtuarit me qëllim por djali im F... ka ndërdua një shupë dhe ka mbështetur disa drunjë për muri që të përforcohet shupa por jo ta dëmtoj më murin e fqijut ,jam i pa punë për çdo ditë dalë në Ferizaj afër Xhamisë për të kërkuar punë mbajtës i trembëdhjetë anëtarëve të familjes kërkoj nga gjykata që të merr të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I akuzuari I.F, në shqyrtimin fillestar deklaroi se e ndien vetën fajtorë dhe e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se shupën e kishte ndërdua djali i tij Rr..., por të njëjtën shupë e kanë rrëzuar djemtë e të dëmtuarit dhe me këtë rast kanë mundur që ta dëmtojnë murin e tyre premtori se në të ardhmen gjithëherë do të jetë i kujdesshëm, është shfrytëzues i asistencës sociale i gjendje jo të mirë shëndetësore, është hera e parë që ndeshet me ligjin, lus gjykatën që ti merr parasysh theksimet e cekura më lartë me rastin e shqiptimit të dënimit nuk do të përsërisim veprime të tilla.

I akuzuari F.A, në shqyrtimin fillestar deklaroi se e ndien vetën fajtorë dhe e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në tersi mbështet deklaratën që ka dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj lidhur me këtë rast me datën 13.08.2019 ka ndërdua një shupë për ti lënë gjësendet e vjetra dhe lartësia nga muri i fqijut ishte 1.30 m, dhe nuk ka pasë qëllim që ti shkaktoj dëm të, tani është pënduar për veprimet që i ka ndërmarrë dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisim veprime të tilla.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht dhe e kanë mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarve gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi pranimi i tillë i fajësisë është bërë konform nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPPK-së.

Gjykata ka vlerësuar se të akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale, në deklaratat e të akuzuarve të dhëna në procedurën hetimore, në deklaratën e të dëmtuarit si dhe shkresave tjera që gjenden në lëndë.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet e veprës penale në bashkëkryerje asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni.321 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese mori se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale me çka kanë treguar sinqeritet gjatë procedurës penale, janë penduar për veprën e kryer, kanë premtuar se veprime të tilla më nuk do të përsëris dhe se me të dëmtuarin nga ky rast nuk kanë pasur diçka të keqe, janë mbajtur të familjes ,gjendjen e varfër të tyre shfrytëzues të asistencës sociale i akuzuari XH.A baba i njëmbëdhjetë fëmijëve i pa punë, i akuzuari I.F, baba i shtatë / 7 / fëmijëve, i pa punë i gjendjes së varfër ekonomike shfrytëzues i Asistencës Sociale, i akuzuari F.A baba i tetë fëmijëve, i pa punë shfrytëzues i asistencës sociale dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre i shqiptoi veç e veç të akuzuarve dënim me kusht si në dispozitiv, duke qenë i bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes së sajë si dhe personalitetit të akuzuarve dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që e akuzuari të mos kryejë vepra tjera penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së të dëmtuarin, H.D, nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i udhëzon në procedurë kontestimore.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e paushallin gjyqësor është marrë konform nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.1010/2019 datë 15.01.2020

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykata.